



Përmbledhje Nr.3 Të përdorësh Përkthyes gjatë Monitorimit të Paraburgimit

Që nga themelimi i saj në vitin 1977, Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT) ka promovuar monitorimin e rregullt e të pavarur të vëndeve të paraburgimit, si një mjet efektiv për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit në burgje. *Seria e re e Përmbledhjeve mbi Monitorimin e Paraburgimit* i bënë analizat kërkimore e studimore të APT-s dhe praktikantët, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në të gjithë botën. Ajo ka si qëllim të plotësojë dhe të sigurojë më shumë detaje mbi aspektet e prezantuara në publikimin e APT-s, *Të Monitorosh Vëndet e Paraburgimit: Një Guidë Praktike*.

Reagimet, komentet dhe sugjerimet mbi përmbajtjen e serisë janë të mirëpritura dhe duhet të dërgohen tek apt@apt.ch.

Maj 2009

1. HYRJE

1.1 Si të Përdorësh këtë Përmbledhje

Kjo përmbledhje është hartuar për tu përdorur nga organizatat që kryejnë monitorime të paraburgimit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar dhe monitoruesit e të cilave mund të kenë nevojë të intervistojnë autoritetet ose personat që u është hequr liria të cilët nuk flasin gjuhën e tyre. Ajo trajton problemet që mund të hasen nga organizatat monitoruese që përdorin përkthyes. Kjo përmbledhje trajton rolin e ndërsjelltë të monitoruesit dhe përkthyesit dhe nxjerrë në pah disa elemente kyç për secilin prej tyre. Tabela përfundimtare jep direktiva për të dy, monitoruesin dhe përkthyesin, bazuar në praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

1.2 Konsiderata fillestare

Monitoruesit e paraburgimit punojnë shpesh në ambiente ku ata nuk flasin gjuhën e një apo më shumë personave që u është hequr liria apo të autoriteteve përkatëse. Për rrjedhojë ata mund të kërkojnë asistencën e një përkthyesi profesionist ose jo ose të zgjedhur në moment¹. Sfidat për të kaluar pengasat e gjuhës, kulturës dhe komunikimit indirekt e komplikojnë detyrën e vështirë të monitorimit.

Për një monitorues paraburgimi, të punosh me një përkthyes kërkon një sër aftësish të lindura ose të përftuara. Përkthimi në vetvete një aktivitet shumë impenjativ. Ai kërkon që përkthyesi të balancojë disa funksione të ndryshme në ndjekje të një kompleksi objektivash. Keq komunikimi mund të ndodh si rrjedhojë e mungesës së përgatitjes dhe trajnimit nga ana e monitoruesit, interpretuesit apo të dyve. Një problem i till mund të ketë impact jo vetëm në procesin e intervistimit por edhe mbi besueshmërinë e organizatës monitoruese.

Si gjithmonë, nuk ka një plan se si duhet të përballësh me sfidat që hasen gjatë monitorimit me përkthyes. Ato duhet të kalohen në mënyrë pragmatike, duke u udhëhequr nga përgatitja dhe politika e përshtatshme, nga parimet etike dhe metodologjia e shqyrtuar mirë.

2. ELEMENTËT PËR PËRCAKTIMIN E POLITIKËS

Organizatat monitoruese të paraburgimit, mund të kërkojnë rregullisht shërbimet e përkthyesve. Nga ana tjetër, ata mund të përballen me këtë nevojshmëri vetëm nganjëherë. Të dyja mundësitë duhet të planifikohen për aq sa është e mundur. Në secilin prej konteksteve organizatat mund të zgjedhin të përdorin përkthyes të zakonshëm, përkthyes të rastit, ose në qoftë se nuk ka opsion tjetër, personat që janë prezent në vend dhe mund të përkthejnë. Në afarë do lloj rasti, ato duhet të marrin kohë për të përgatitur një politikë mbi përdorimin e përkthimit me qëllim standartizimin e praktikës, sigurimin e cilësisë dhe shmangien e vështirësive në praktikë. Disa elementë që duhet të merren në konsideratë janë:

2.1 Rekrutimi dhe Ekzaminimi

Profesionist ose jo profesionist: Vendimi i parë që do të merret me doemos është nëse puna e organizatës kërkon – dhe mund të ketë akses tek- përkthyes profesionistë. Në

¹ Për qëllimet e kësaj përmbledhjeje, termi "përkthyes" i referohet profesionistëve dhe jo profesionistëve që bëjnë përkthime si dhe personave që përzgjidhen në moment për të bërë përkthimet në vend gjatë vizitës monitoruese.

qoftë se jo, organizata duhet të konsiderojë se si të përgatisë dhe pozicionojë jo-profesionistët. Në cdo rast, është e preferueshme të lidhen kontrata formale që të përcaktojnë kohëzgjatjen e kontratës, termat e referencës, shpërbimin dhe kushtet e pagesës, dhe kushtet e shërbimit. Një dosje personale duhet të mbahet për cdo përkthyes.

Pagesa dhe shpenzimet: Pavarësisht në qoftë se do të përdoren profesionist apo jo, pyetja që lind është: A mundet organizata ti paguaj ata për shërbimin e tyre? Edhe në qoftë se do të përdoren vullnetarë, me çfarë shpenzimesh të tjera do të përballet organizata, si për shëmbull ato të transportit dhe ushqimit? A ka ndonjë benefit alternative që mund ti sigurohet vullnetarëve si për shëmbull mundësi për zhvillimin e tyre profesional?

Ndërkombëtar ose kombëtar: Organizatat ndërkombëtare zakonisht kanë opsionin të marrin përkthyes që flasin gjuhën vëndase por që nuk jetojnë në vëndin përkatës. Kjo jep më shumë siguri për përkthyesin se sa kur ai vazhdon të qëndrojë në po atë vend më pas. Megjithatë kjo do të thotë që përkthyesi mund të jetë larguar nga realiteti vëndas dhe të jetë më pak i aftë për të siguruar përjasje me kulturën vëndase. Një rast i till ka edhe komplikime për sa i përket shpenzimeve.

Vendas ose jo-vendas: Duke marrë në konsideratë sigurinë sugjerohet se është më mirë të mos përdoren përkthyes vëndas (rezident në atë pjesë të vëndit ku do të kryhet monitorimi) duke qenë se ata vendosen në rrezik. Përdorimi i përkthyesve vëndas rrezikon që ata të mos jenë të pavarur si rrjedhojë e njohjeve e lidhjeve të mundshme që mund të kenë në vëndin që monitorohet. Për më tepër, përdorimi i një përkthyesi vëndas rrit mundësinë e prishjes së konfidencialitetit. Nga ana tjetër, disa persona që intervistohen preferojnë të flasin me dikë që njohin ose që mund të krijojnë një lidhje. Në këtë aspekt, përdorimi i përkthyesve vëndas mund të sjell avantazh për sa i përket krijimit të konfidencës dhe përjasjes kulturore.

Etnia, gjinia, mosha dhe talentet: Organizatat duhet të jenë idealisht fleksibël në përzgjedhjen e përkthyesve sipas moshave, gjinive, kulturave, etnive dhe talenteve të ndryshme si dhe aftësive linguistike në mënyrë që ti përshtaten identiteteve dhe nevojave të të intervistuarve.

Ekzaminimi: Është shumë e rëndësishme të punohet me përkthyesit që nuk janë jo vetëm kompetent për të përkthyer por edhe të aftë për tju bindur standarteve profesionale dhe praktikave etike. Gjithashtu është thelbësore që ata të dallohen gjatë ekzaminimit. Fatkeqësisht, nuk është e padëgjuar që përkthyesit të përfitojnë nga pozita e tyre si përkthyes, në lidhje me anëtarët e tjerë të komunitetit. Organizata monitoruese duhet të ekzaminojë përkthyesit e mundshëm nëpërmjet intervistave të kujdeshme, përdorimit të rasteve studimore, paraqitjes së referencave dhe kontaktimit sipas rastit me agjensitë përkatëse të Kombeve të Bashkuara, NGO-të dhe autoriteteve kombëtare të kandidatit.

Përkthyesit e rastit: Monitorët e paraburgimit mund ta gjenjën vetën në mënyrë të papritur, duke pritur të intervistojnë dikë që nuk di të flakë të njëjtën gjuhë me ta dhe nuk kanë një përkthyes prezent. Në këtë situatë, gjëja e parë që një monitorues duhet të bëjë është të shikojë në qoftë se ata mund të arrijnë të komunikojnë. Kjo mund të arrihet duke bërë pyetje që kërkojnë përgjigje me fjali të plotë dhe të cilat nuk janë kaq të njohura sa një jövëndas mund të jetë i familjarizuar me to automatikisht, në mënyrë që të mos krijohet impresioni i gabuar i se ai flet rrjedhshëm. Në qoftë se është e qartë se është e pamundur të komunikohet sic duhet, monitoruesi duhet të gjejë një përkthyes. Në qoftë

se kjo nuk është e mundur, ai mund të kthehet më vonë me një përkthyes. Megjithatë, kjo mund të mos jetë e mundshme ose akoma më shumë, mund ta vendosë ndërkohë personin në rrezikë. Ai mund edhe të transferohet në një vënd tjetër.

Në këtë kontekst, monitoruesi mund ti duhet të kërkojë që ndonjë person prezent të bëjë përkthyesin. Kjo duhet të shërbejë si zgjidhje e fundit duke qenë se këta persona ka shumë mundësi të mos kenë aftësitë ideale. Ata mund të mos kuptojnë nevojshmërinë për të ruajtur konfidencialitetin ose mund të kenë interesa ose motive të tjera. Madje dhe si rezultat i qëllimeve të mira, anëtarët e familjes ose shokët mund të ndryshojnë bisedën duke shtuar opinionet dhe informacionet e tyre. Nga ana tjetër, i intervistuari në fjalë mund të mos dojë të diskutojë disa çështje nëpërmjet anëtarëve të familjes ose personave të tjerë prezent.

Në këtë situatë, është të përdorësh dikë që e propozon vet i burgosuri në fjalë. Në qoftë se ky person nuk është por persona të tjerë dalin vullnetar, monitoruesi duhet të vërejë nga afër reagimin e të intervistuarit dhe të menaxhojë çështjen me këmbëngulje. I intervistuari mund të jetë i lëkundur për të shprehur dëshirën e për të mos përdorur atë person, për një sërë arsyesh.

Kushdo që është zgjedhur të përkthejë, monitoruesi duhet të qartësojë vetën se kush është përkthyesi potencial, çfarë marrëdhënie ka ai me të intervistuarin dhe ti shpjegojë atij që në fillimë se cili do të jetë roli i tij. Në qoftë se monitoruesi është i pasigurt rreth një përkthyesi të rastit, është më mirë që të mos gabojë dhe të mundohet të gjejë dikë tjetër ose një zgjidhje tjetër si ajo për të shtyrë intervistën deri sa të gjëndet një person i përshtatshëm.

2.2 Direktiva të brëndshme në lidhje me monitorimin dhe intervistat në burg

Për të qenë konsistente dhe cilësore, organizatat monitoruese duhet të zhvillojnë direktiva të brëndshme të qarta në lidhje me kryerjen e intervistave. Këto direktiva duhet të ndahen me përkthyesit dhe duhet të trajtojnë çështjet që përfshijnë por nuk kufizohen si më poshtë:

- Problemet e aksesit dhe pranimit të përkthyesve;
- Kur duhet përdorur një përkthyes mashkull dhe kur një përkthyes femër për arsye të sigurisë dhe efektivitetit;
- Kur, ku dhe në çfarë kushtesh duhet të kryhet intervista;
- Kush duhet të jetë prezent;
- Cili duhet të jetë qëllimi dhe limitet e rolit të secilit prej pjesëmarrësve në intervistë;
- Si duhet të jetë procesi i intervistimit;
- Problemet e komunikimit;
- Intervistimi i personave që bëjnë pjesë në grupet vulnerabël;
- Detyrat e përkthyesit.

2.3 Informacioni, Trajnimi dhe Kodi i Etikes dhe Sjelljes

Në rastin kur përdoret një përkthyes i rastit, monitoruesi duhet të bjeri dakort me të, përpara fillimit të intervistës, në lidhje me disa instruksione të thjeshta të paravendosura nga organizata. Kjo e ndihmon përkthyesin të kuptojë rolin e tij dhe monitoruesin të menaxhojë procesin.

Përkthyesve të rregullt që punojnë me organizata monitoruese, qofshin profesionist ose jo, duhet tu jepet për ta mësuar dhe nënshkruar një kod sjelljeje I cili vendos standartet etike sipas të cilave ata duhet të sillen.² Atyre duhet tu jepen gjithashtu direktiva mbi monitorimin dhe intervistimin e referuar më sipër.

Këto dokumente dhe probleme të tjera përkatëse duhet të diskutohen dhe pranohen si nga monitoruesit ashtu dhe nga përkthyesit, në seanca specifike e periodeke trajnimi me pjesëmarrjen e preferueshme të përkthyesve dhe monitoruesve me eksperiencë. Studimi i shëmbujve dhe interpretimi i roleve duhet të përbëjnë një pjesë thelbësore të këtij procesi. Trajnimi duhet të sigurojë një mundësi për përkthyesit që të krijojnë marrëdhënie me monitoruesit si dhe të kuptojnë metodologjinë. Kur është e përshtatshme, përkthyesve të rinjë mund tu bëhet një prezantim i organizatës në mënyrë që ata të krijojnë një ide më të gjërë të punës së tyre.

2.4 Suporti ndaj përkthyesve

Përkthyesit mund të kenë pasoja të dëmshme psiko-sociale nga puna e tyre me personat që u është hequr liria. Këtu përfshihet inati, stresi, depresioni, përjetimi I traumës. Ata mund të ndeshen edhe me vështirësi në marrëdhënien e tyre me kolegët monitorues ose në zgjidhjen e problemeve të tjera që lidhen me punën e tyre. Organizatat monitoruese duhet të kërkojnë të krijojnë kushte të tilla që përkthyesit të mund të kalojnë këto vështirësi. Disa mënyra për ta bërë këtë janë:

- Të sigurosh përkthyes që kanë “një pikë kontakti” në organizatën monitoruese i cili mund të japë support, por nuk është monitorues;
- Të sigurosh informacion mbi impaktin e mundshëm psiko-social që mund të ketë puna monitoruese mbi përkthyesit vetë dhe se si këta të fundit mund ta përballojnë atë³;
- Të trajtohen problemet e ushqimit, pushimit, orëve të punës dhe nevojave të tjera në direktivat e brendshme dhe trajnimet për monitoruesit që punojnë me përkthyes;
- Të bëhen të qarta që në fillim detyrat shtesë që priten të kryen nga përkthyesit;
- Të sigurohet që monitoruesit të mbledhen me përkthyesit përpara dhe pas intervistave ose vizitave monitoruese, si të jetë e përshtatshme. Të kryen vlerësime periodeke të performancës bazuar në kritere transparente, në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i përkthyesve.⁴

2.5 Siguria dhe Raprezaliet

Përkthyesit që punojnë në monitorimin e paraburgimit mund të bëhen viktimat të raprezalieve apo veprimeve të tjera të padëshirueshme. Për më tepër, veprimet e përkthyesve mund të vendosin në rrezik edhe personat e tjerë të përfshirë në procesin e monitorimit. Organizatat monitoruese duhet të kërkojnë të parandalojnë këto raste dhe njëkohësisht të jenë të përgatitura për te reaguuar në rast se ndodhin. Se si mund të bëhet kjo, varet nga konteksti i vecantë i rastit por në përgjithësi, përkthyesit dhe familjarët apo shokët e tyre duhet të kenë mundësinë të kontaktojnë me organizatën monitoruese 24 orë në ditë. Duhet të jetë e ndaluar në mënyrë strikte kontakti i

² Për shembull, shiko Fondacionin Mjekësor për Kujdesin ndaj Viktimave të Torturës, *Kodi I Praktikës dhe Etikës për Përkthyesit dhe Praktikantët që Punojnë Sëbashku*, 2005; UNHCR, *Përkthyesit në një Kontekst Refugjati:Moduli Vet-Studiuës 3, Aneksi I*, 2009

³ Shiko UNHCR, *Përkthimi në një Kontekst Refugjati*, 2009

⁴ Për direktiva vlerësuese që mund të jenë të përshtatshme për një kontekst monitorimi, shiko Shoqatën Ndërkombëtare të Përkthyesve Mjekësor, *Standartet e Praktikës së Përkthimit Mjekësor*, 2007 dhe Këshilli Ndërkombëtar mbi Përkthimin në Kujdesin Shëndetësor, *Standartet Kombëtare të Praktikës për Përkthyesit në Kujdesin Shëndetësor*, 2005

dyanshëm midis autoriteteve lokale si përshëmbull policisë dhe përkthyesve. Në qoftë se një përkthyes kontaktohet nga autoritetet në lidhje me monitorimin, ai duhet ti drejtojë ata të kontaktojnë direkte me organizatën monitoruese. Cdo kontakt i autoriteteve për çfarë do lloj arsye, duhet të raportohet tek pika e kontaktit që ka përkthyesi në organizatë. Në asnjë rast përkthyesi nuk duhet të ketë akses tek arkiva e përgjithshme e dosjeve, tek dosjet e rasteve individuale ose tek të dhënat që kanë informacion konfidencial.

3. SFIDAT KONCEPTUALE DHE SFIDAT E TJERA

3.1 Elementet Etik për Monitoruesit e Paraburgimit dhe Përkthyesit

Parimet etike për monitoruesit trajtohen në publikimin e APT-së *Monitorimi I Vëndeve të Paraburgimit: Një Guidë Praktike*. Këto parime janë të rëndësishme jo vetëm për të siguruar konsistencë dhe profesionalizëm në procesin e intervistimit por edhe për të lehtësuar parashikueshmërinë-dhe për rrjedhojë kontrollin-për të intervistuarit.

Përkthyesit duhet gjithashtu të respektojnë standartet etike përkatëse. Një kod i shkruar mbi etikën/ sjelljen dhe direktivat mbi metodën e të punuarit, për përkthyesit dhe monitoruesit, janë thelbësore, sic është theksuar dhe më sipër. Ato mund të ndihmojnë në shmangien e konfliktit, konfuzionit dhe gabimeve.

Është e rëndësishme që, që në fillim të kërkosh reagim nga përkthyesit për sa i përket aftësisë së tyre për të ndjekur pritshmëritë etike dhe pritshmëritë e tjera, pasi ajo që bën sens në një kontekst mund të mos bëjë sens në një tjetër. Një diskutim i hapur mund të ndihmojë në përmirësimin e kodit dhe direktivave dhe në shmangien e vështirësive në praktikë. Parimet kyçe që dihet të jenë pjesë e kodit etik për përkthyesit, përfshijnë:

- Mos bej keq
- Konfidencialiteti
- Paanshmëria
- Përpikmëria
- Respekti
- Ndjeshmëria
- Mos-diskriminimi
- Distanca profesionale

Përkthyesit duhet të kenë përgjegjësinë dhe të drejtën për të hequr dorë nga një detyrë e caktuar në rast se ata ndihen të pa aftë për ta përbushur atë në mënyrë profesionale. Kjo mund të ndodhë për arsye të konfliktit të interesit, vlerave personale ose kur ata duhet të përkthejnë në situatë të tilla në të cilat ata ndihen të patrajnuar ose jo të kualifikuar.

3.2 Roli I Monitoruesit

Cështja e kufizimeve në rolin profesional ka më shumë mundësi të lindi në rastet e kryerjes së intervistave për monitorimin e paraburgimit, nëpërmjet përkthyesve. Problemet që rezultojnë, duhet të trajtohen hapur përpara monitorimit, në mënyrë që të shmangjen vështirësitë në praktikë.

Edhe pse punojnë me përkthyes, monitoruesit vazhdojnë të kenë përgjegjësi të plotë për të siguruar që objektivat etike, profesionale dhe procedurale të intervistës të arrihen. Monitoruesit dhe jo përkthyesit, janë përgjegjës për menaxhimin e procesit intervistues.

Megjithatë, monitoruesit duhet të respektojnë dhe të mësojnë që të përfitojnë në mënyrë objektive nga aftësitë dhe njohuritë e përkthyesit.

Është e dobishme për monitoruesit që të kalojnë ca kohë me përkthyesit përpara se të punojnë sëbashku në mënyrë që të dy palët të arrijnë të kuptohen dhe të ndajnë të njëjtat pritshmëri. Kjo ndihmon në përgatitjen për sfidat e pritshme. Në disa kontekste, dyshja monitorues-përkthyes vendos disa sinjale për ti përdorur gjatë vizitës monitoruese dhe intervistave. Këto sinjale mund të jenë verbale ose fizike dhe përdoren në rastet kur është e nevojshme të ndërpritet intervista; kur duhe ndryshuar linja e intervistës; kur ka një problem; kur duhet të diskutojnë dicka ndërmjet tyre; kur duhet folur më ngadal ose më shpejtë; etj.

3.3 Roli i Përkthyesit

Përkthyesit profesionist kuptojnë kompleksitetin e thellë dhe dilemat e asaj që mund ti duket një detyrë e thjeshtë, të tjerëve. Në terma të përgjithshëm, roli më i përshtatshëm për përkthyesin në cdo kohë gjatë intervistës, është të jetë sa më pak invaziv për të siguruar një komunikim efektiv. Për më tepër, ai duhet të punojë në cdo kohë në mënyrë që prioriteti i marrëdhënies monitorues-i intervistuar të mos çënohet nga marrëdhënia monitorues-përkthyes ose përkthyes-i intervistuar.

Rolet kryesore të përkthyesit gjatë intervistës janë:

- 1) Ndërlidhës
- 2) Përqasës kulturor
- 3) Qartësues
- 4) Mbrojtës

Ndërlidhës: Ky është roli bazë i përkthyesit, të cilin ai duhet të luaj shumicën e kohës. Ky rol përfshinë regjistrimin dhe përkthimin e kuptimit të asaj që është thënë nga një gjuhë në një tjetër pa shtesa apo ndryshime. Mesazhi i përkthyer duhet të jetë në vetën e parë të përdorur nga i intervistuari. Roli i ndërlidhësit duhet të kryhet deri sa përkthyesi percepton një keqkuptim potencial të qartë qoftë nga ana e të intervistuarit ashtu dhe nga ana e monitoruesit. Përkthyesi ka rolin të menaxhojë rrjedhën e komunikimit për të siguruar përpikmërinë e përkthimit.

Përqasës kulturor: Gjuha është rronjosur në besimet, perceptimet, vlerat dhe prezumimet me bazë kulturore, që sistemojnë realitetin në mënyrë subjektive. Në rolin e përqasësit kulturor, përkthyesi siguron një kuadër të nevojshëm për të kuptuar mesazhin që përkthehet në secilin prej drejtimeve. Përkthyesi duhet të ketë një rol të till kur diferencat kulturore të përkthyer fjalë për fjalë mund të cojnë në keqkuptim qoftë nga ana e të intervistuarit ashtu dhe nga ana e monitoruesit. Megjithatë, si monitoruesi ashtu dhe përkthyesi duhet të jenë të ndërgjegjshëm për limitet e përkthimit si rrjedhojë e ndikimit të kulturës personale të vetë përkthyesit. Pavarësisht sesa shumë informacion ka përkthyesi rreth besimeve, vlerave, normave dhe zakoneve, besnikëria ndaj kuadrit kulturor është subjekt i perceptimit joperfekt dhe varion nga nje grup në tjetrin dhe nga një individ në tjetrin. Roli i përqasësit kulturor është më i besdisshëm sesa ai i ndërlidhësit.

Qartësues: Në këtë rol, përkthyesi përshtat, regjistron dhe shpjegon konceptet komplekse, termat që nuk kanë një ekuivalent preçiz linguistik ose ekuivalenti i tyre linguistik mund të mos jetë i kuptueshëm dhe kërkon shpjegim. Në kontekstin e intervistave për monitorimin e paraburgimit, ky është një rol thelbësor që përkthyesi luan

në lidhje me monitoruesin. Megjithatë monitoruesi është përgjegjësi parësor për të bërë qartësime- nëpërmjet përkthyesit-kur i intervistuari nuk kupton. Vetëm kur tentativa e monitoruesit dështon dhe me pëlqimin e shprehur të tij, përkthyesi merr rolin e qartësuesit në lidhje me të intervistuarin

Mbrojtës: Përkthyesi duhet të marrë rolin e mbrojtësit vetëm në situatat më ekstreme kur janë ezauruar të gjitha opsionet e komunikimit me monitoruesin dhe si alternativë absolutisht e fundit. Në këtë rol, përkthyesi merr në dorë kontrollin e situatës dhe e çon në fund intervistën. Kjo ndodh në rastet kur monitoruesi ose humbet plotësisht kontrollin e procesit ose silltet në mënyrë të tillë që mund të ketë një impakt serioz e dëmtues për sa i përket të drejtave të njeriut ose mirëqënies së të intervistuarit. Që një situatë e tillë të mos përsëritet më, organizata monitoruese duhet të shqyrtojë si sjelljen e monitoruesit ashtu dhe të përkthyesit.

3.4 Detyra të tjera të zakonshme për përkthyesit

Mban shënime: Është një praktikë e vendosur mirë që kur dy monitorues intervistojnë një persona që i është hequr liria, njëri prej tyre drejton bisedën ndërsa tjetri mban shënime. Në rastin e intervistave që kryen me përkthyes kjo bëhet më komplekse. Kryerja e intervistës me dy monitorues dhe një përkthyes mund të jetë jopraktike, e padëshirueshme dhe mund ta frikësojë të intervistuarin potencial. Në rastin kur është vetëm një monitorues dhe përkthyesi, monitoruesi mund të zgjedh ti mbajë vet shënimet edhe njëkohësisht të drejtojë bisedën, por kjo mund ta shpërqëndrojë nga bashkëveprimi me të intervistuarin. Në këtë rast përkthyesi mund të mbajë shënimet. Megjithatë kjo mund ta shpërqëndrojë edhe atë nga puna e tij primare. Në këto kushte, në fund të fundit, përkthyesi mund të mbajë shënim vetëm të dhënat kyce si data, afate, emra të cilat mund ti hyjnë në punë më vonë monitoruesit.

Burim idesh: Një përkthyes me eksperiencë në fushën e monitorimit mund të jetë një burim thelbësor perceptimi dhe të plotësojë mirëkuptimin e intervistës nga vet monitoruesit. Megjithatë sa më shumë të përfshihet përkthyesi në rolin analitik të monitoruesit aq më shumë rriten shanset e lindjes së konfliktit apo konkurrencës midis të dyve.

Logjistik dhe përkthim: Shpesh përkthyesit marrin rol logjistik, kryesisht për organet ndërkombëtare monitoruese. Ata mund të thërriten të organizojnë transportin, telefonatat, rezervimet e restorantit ose caktimin e takimeve. Shpesh monitoruesit marrin dokumenta në gjuhën vëndase, në këto raste përkthyesit thërriten të sigurojnë përkthimin e tyre. Monitoruesit duhet të tregohen të kujdesshëm që të mos shfrytëzojnë ose të abuzojnë me funksionet shtesë të përkthyesve.

3.5 Cështje të tjera mbi Monitoruesit dhe Përkthyesit

Shumë sfida të tjera ekzistojnë për monitoruesit dhe përkthyesit të cilat duhet të diskutohen më përparë, në qoftë se është e mundur. Disa nga këto janë:

Të intervistuar sfidues: Shumë të intervistuar e kanë të vështirë të japin informacion në mënyrë të fokusuar, sistematike, kronologjike dhe të qartë sic preferojnë monitoruesit. Disa flasin për një kohë të gjatë pa ndërprerje. Në këtë rast, monitoruesi duhet të përpiqet ti shpjegojë të intervistuarit nevojën për ecur hap pas hapi në mënyrë për të kuptuar historinë e tij. Në qoftë se kjo nuk funksionon, monitoruesi/ përkthyesi mund ta ndërpresin atë periodikisht por kjo mund të shqetësojë rrjedhën e mendimeve të të intervistuarit. Si rezultat, përkthyesi mund të jetë i detyruar të bëjë një përmbledhje të

asaj që po thotë i intervistuari. Kjo nuk është ideale dhe monitoruesit do ti duhet të bëjë pyetje herë pas here ose në fund të gjithë historisë, në mënyrë që të kontrollojë në qoftë se e ka kuptuar drejtë atë.

Përkthim i përshpëritur ose i njëpasnjëshëm: Disa monitores preferojnë që përkthimi të përshpëritet në veshin e tyre në mënyrë që të mos ndërpritet rrjedha e intervistës. Disa të tjerë preferojnë përkthim të njëpasnjëshëm si në rastet kur monitoresi/ I intervistuari ndalojnë me intervale në mënyrë që përkthyesi të përkthejë. Të tjerë zgjedhin metodën përkatëse në varësi të llojit të komunikimit në intervistë.

Menaxhimi I konflikteve midis monitoruesit dhe përkthyesit gjatë intervistës: Në disa raste, marrëdhënia midis monitoruesit dhe përkthyesit mund të disbalancohet gjatë intervistës. Monitoruesi është përgjegjës për të menaxhuar këtë situatë pavarësisht shkakut. Ai duhet të kontrollojë gjuhën e trupit dhe ekspresionin e fytyrës në mënyrë që problemi të mos bëhet evident për personat e tjerë prezent. Ai duhet të flasë qetësisht me të intervistuarin dhe ti thotë se duhet të kontrollojë kuptimin e dickaje me përkthyesin. Përsëri me qetësi ai duhet ti kujtojë përkthyesit nevojën për të ruajtur besueshmërinë përpara personave prezent dhe duhet ti referohet direktivave të organizatës në qoftë se është e nevojshme. Në qoftë se problemi nuk zgjidhet shpejt, intervista duhet të ndalohet në një mënyrë që të mos bëhet e dukshme për të tjerët ajo çfarë ndodhi dhe të mos shkaktohet asnjë siklet ose konfuzion tek i intervistuari. Përkthyesi dhe monitoruesi duhet ta diskutojnë problemin jashtë ambienteve ku zhvillohet intervista dhe në qoftë se është e nevojshme të rikthehen përsëri brenda ose të gjejnë një alternativë tjetër në qoftëse mospajtimet e tyre duken të pakapërcyeshme për momentin.

3.6 Faktori i panjohur: Situata dhe perspektiva e të intervistuarit

Historia, eksperiencia, situata psiko-sociale, konteksti i paraburgimit, motivet dhe pikëpamjet individuale të cdo të intervistuari rrallë herë mund të njihen më për para nga monitoruesit. Në të njëjtën kohë, mënyra se si i intervistuari percepton monitoruesit dhe përkthyesit është gjithashtu e vështirë për të parashikuar. Disa mund të jenë dyshues ndaj një përkthyesi të të njëjtit vënd dhe të reagojnë mirë ndaj personave të ardhur nga një vend tjetër. Të tjerë mund të ndihen më të sigurt me dikë (të afërt me të) dhe të mos besojë të huajt ose të tjerët që I percepton si të ndryshëm. Disa të tjerë mund të preferojnë të diskutojnë disa çështje me persona të një etniteti ose gjinie të caktuar. Mundësitë janë të pafundme. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në bashkëveprimin e të intervistuarit me monitoruesin dhe përkthyesin. Këta të fundit duhet të jenë mjaftushmërisht të mprehtë për ti vlerësuar këto problemet dhe për të reaguar ndaj tyre në moment.

4. DIREKTIVAT

Është e volitshme të konsiderosh marrëdhënien midis monitoruesit dhe përkthyesit në tre faza: përpara, gjatë dhe pas intervistës. Më poshtë gjenden disa direktivat për monitoruesit dhe përkthyesit, respektivisht për secilën fazë.

MONITORUESIT		
Direktiva për punënë me përkthyesit		
Bëj		Mos bëj
Përpara	<ul style="list-style-type: none"> • Beji përkthyesit një përmbledhje paraprake në lidhje me pritshmëritë e tua në lidhje me procesin e intervistimit. • Ftoje përkthyesin të të këshillojë mbi çështjet e kulturës dhe çështje të tjera. • Sigurohu që çështjet ndërpersonale midis teje dhe përkthyesit të lihen mënjane përpara intervistës. • Jepi paraprakisht përkthyesit kopje të materialeve të shkruara që do ti jepen të intervistuarit. • Siguro të dhëna në lidhje me numrin e personave që do të jenë të përfshirë në intervistë në mënyrë që të shmangësh që i intervistuari të friksohet. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos fillo intervistën pa u familjarizuar në fillim me përkthyesin.
Gjatë	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanto vetveten. Në qoftë se di ndonjë fjalë në gjuhën e të burgosurit, prezanto vetveten drejtëpërdrejtë përpara se tja lësh në dorë përkthyesit. • Prezanto përkthyesin dhe shpjego rolin e tij. • Bëj të mundur që i intervistuari të shprehet nëse preferon të mos përdoret përkthyesi. • Kushtoi vëmendje elementëve joverbal të cilët mund të tregojnë se i intervistuari është në siklet nga përkthyesi ose nga ndonjë faktor tjetër. • Bëj kujdes ndaj sugjerimeve të përkthyesit në lidhje me të intervistuarin apo faktorët e tjerë. • Ulu ballë për ballë me të intervistuarin dhe me përkthyesin në njërën anë i cili të ketë pamje të plotë dhe të rehatshme të të dyve ju. Si alternativë, uluni në formën e një trekëndëshi barabrinjës ose në rreth kur jeni disa veta. • Vështro të intervistuarin ndërkohë që fletë ose dëgjon përkthyesin. • Përdor kontaktin me sy dhe ji i vëmendshëm ndaj gjesteve trupore. • Flit më ngadalë dhe më qartë se zakonisht për të ndihmuar përkthyesin dhe për të qetësuar të intervistuarin. • Përdor gjuhë të lehtë dhe siguro informacion të qartë dhe të saktë. Bëj pyetje të shkurtra duke i formuluar ato paraprakisht në mendje përpara se ti thuash me zë. • Ndalo pas cdo dy apo tre fjalish për të lejuar përkthyesin të transmetojë mesazhin. • Përdor pyetje dhe deklarata të drejtëpërdrejta, si për shembull “A të kujtohet se çfarë ngjyre ishin muret?” dhe jo “Pyete atë nëse kujton se çfarë ngjyre kanë qenë muret. • Duhet të jesh i gatshëm të riformulosh pyetjet e tua. • Duhet të jesh i qetë. Intervistat me përkthyes zgjasin më shumë se intervistat e drejtëpërdrejta. • Prit për të mbarojë përkthimi përpara se të reagosh edhe në qoftë se mendon se e ke kuptuar përgjigjen e të intervistuarit. • Bëj përmbledhje të herë pas herëshme kur ke të bësh me çështje komplekse ose i intervistuari e ka të vështirë të tregojë në një mënyrë të strukturuar. • Bëj pyetje qëllimisht jo të sakta për të kontrolluar perceptimin tënd. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos fol me zë të lartë kur sështë e nevojshme. • Mos bëj pyetje të shumëfishta. (Një shëmbull i pyetjes së shumëfishtë është: Cfarë ndodhi kur ti arrite, a të pyetën për emrin, ose a të kërkuan ty dhe çfarë të thanë?). • Mos kërkto të kursesh kohë duke i kërkuar përkthyesit të përmbledhi atë çfarë thotë i intervistuari përveç se kur është e absolutisht e domosdoshme. • Mos i lërë përkthyesit kontrollin e intervistës. • Mos e lejo përkthyesin të marri kontrollin e intervistës.

Përmbledhje Nr.3 e APT mbi Monitorimin e Burgimit

	<ul style="list-style-type: none"> • Përpara përfundimit të intervistës, konsultohu me përkthyesin mbi cdo perceptim ose vërejtje që duhet trajtuar me të. • Bisedo mënjandë me përkthyesin sa më pak të jetë e mundur dhe në qoftë se biseda zgjatë më shumë se disa sekonda, jepi ca shpjegime të intervistuarit. • Bëj kujdes me përdorimin e shakave. Humori mund të mos përkthehet mirë. 	
Pas	<ul style="list-style-type: none"> • Përmblihdh me përkthyesin substancën e intervistës në rast se ke nevojë për qartësime, informacion dhe në qoftë se është e përshtatshme, për një opinion shtesë. • Përmblihdh me përkthyesin, në mënyrë konstruktive, metodat e punës tuaj të përbashkët në mënyrë që të përmirësoheni në të ardhmen. • Trajtoje përkthyesin me respekt dhe njihe punën e tij. 	

PËRKTHYESIT

Direktiva për punën me monitoruesit

	Bëj	Mos bëj
Përpara	<ul style="list-style-type: none"> • Merr me vete një bllok shënimesh dhe stilolaps. • Konsultohu me monitoruesin për cdo dyshim procedural, linguistic apo dyshim tjetër që mund të kesh. • Informo monitoruesin mbi çështjet e rëndësishme kulturore që kanë të bëjnë me mënyrën e të veshurit, zakonet e përshëndetjes, hierarkinë, çështjet e gjinisë, etj. • Bëj të ditur cdo arsye për të cilën ju mendoni se nuk duhet të merrni pjesë në intervistë. 	
Gjatë	<ul style="list-style-type: none"> • Ulu në mënyrë të till që të kesh pamje dhe dëgjim të mirë si të monitoruesit ashtu dhe të të intervistuarit. • Mbaj shënim detaje si data, shifra dhe emra në mënyrë që të ndihmojnë monitoruesin më vonë. • Shëno në bllok cdo informacion të ndjeshëm. • Shënoi gjërat që duhen rishqyrtuar ose që duhen diskutuar me monitoruesin më vonë. • Përdor përkthimin e drejtëpërdrejtë sa më shumë të jetë e mundur. • Ji i vetdijshëm për gjestet dhe ekspresionet e tua të fytyrës. • Qartëso me monitoruesin pyetjet që nuk kupton, por mos vërë në diskutim pyetjet e tij përvec se në rastin kur ka rrezik që ato të shkaktojnë fyerje serioze kulturore ose ndonjë gjë tjetër që mund të dëmtojë intervistën. • Shmang fjalitë shumë të gjata. • Ndërpri të burgosurin në qoftë se ai flet shumë gjatë ose shumë shpejtë. Kjo gjë duhet të bëhet me takt dhe në momentet e duhura. • Mbështet monitoruesin të drejtojë intervistën. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos u përpiq të bësh punën e monitoruesit. • Mos lejo që vlerat dhe bindjet e tua të ndikojnë në intervistë. • Mos ndrysho, plotëso apo zgjero pyetjet ose përgjigjet që përkthen. • Mos ju përgjigj pyetjeve të të intervistuarit që i drejtohen intervistuesit ose anasjelltas edhe në qoftë se e di përgjigjen. • Mos lërë pas bllokun e shënimeve. • Mos l paraprij pyetjeve të monitoruesit pavarsisht se sa herë e ke ndjekur këtë procedurë më parë.
Pas	<ul style="list-style-type: none"> • Respekto konfidencialitetin e procesit të monitorimit. • Trajto cdo vështirësi me monitoruesin pas përfundimit të procesit të monitorimit. 	

5. KONKLUZIONE

Për të kaluar sfidat që dalin nga intervistimi me përkthyes duhet një politikë e qartë nga ana e organizatës dhe disiplinë, praktikë e mirë dhe improvizim i mprehtë nga ana e monitoruesve dhe përkthyesve.

Është thelbësore të kihet parasysh se mirëqënia, rehatia dhe interesi i të burgosurve-të intervistuar duhet të jetë në çdo kohë, shqetësimi primar i monitoruesve të paraburgimit. Monitoruesi është përgjegjës për drejtimin e intervistës dhe lehtësimin e punës së përkthyesit. Nga ana tjetër, roli kryesor i përkthyesit është të sigurojë një kanal lidhës linguistic dhe kulturore në mënyrën më pak invazive në mënyrë që të ruaj integritetin e përcimit të informacionit. Megjithatë rolet e tjera të përkthyesit janë thelbësore vecanërisht në rastet kur monitoruesit ndërkombëtar punojnë në një kontekst të pa njohur.

Ka nevojë për të qenë realist. Studimet tregojnë se edhe një përkthyes profesionist që punon në kushte ideale mund të përkthejë vetëm 70-80% të asaj që është thënë. Durimi nga të dyja palët, si nga monitoruesi ashtu dhe nga përkthyesi, është thelbësor për ta bërë intervistën monitoruese sa më efektive të mundshme për të siguruar të drejtat e personit të cilit i është hequr liria.



Shënim: Kjo përmbledhje sjell eksperiencën e stafit të APT-s dhe homologëve të tyre. Ajo gjithashtu sjell materiale nga, ndër të tjera:: UN DPKO, *Manual Guidë për Suportin nda Burgut: Aneksi 4: Guidë për të Punuar me Përkthyesit*, 2006; Massachusetts Department i Shëndetit Publik, *Praktikat më të mira të Rekomandimeve për Shërbimin e Përkthyesve në Spitale*, data është e panjohur; Qendra për Viktimat e Torturës, *Të Mbyllësh Hapësirat: Duke përdorur përkthyes të trajnuar*, Shkurt-Mars 2001; Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës, *Struktura për Sesionin e Trajnimit në lidhje me Përdorimin Efektiv të Përkthyesve gjatë Vizitave të CPT-së*, 2001; Këshilli Kombëtar mbi Përkthimin në Kujdesin Shëndetësor, *Standartet Kombëtare të Praktikës së Përkthyesve në Kujdesin Shëndetësor*, 2005; Shoqata Ndërkombëtare e Përkthyesve Mjekësor, *Standartet e Praktikës së Përkthimit Mjekësor*, 2007; Ministria Australiane e Shëndetësisë, *Guidë për të Punuar me Përkthyesit në Ambientet e Shëndetësisë*, data është e panjohur; Fondacioni Mjekësor për Kujdesin ndaj Viktimave të Torturës, *Kodi i Praktikës dhe Etikës për Përkthyesit dhe Praktikantët gjatë Punës së Përbashkët*, 2005; UNHCR, *Përkthyesit në një Kontekst Refugjatësh: Moduli Vet-Studiuues 3*, 2009; OSCE, *Të Punosh me ose si Përkthyes*, data është e panjohur; dhe www.diversityrx.org